



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3, të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke u bazuar në nenin 11 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, me Nr. Prot. 01-494/A, të datës 29.10.2024, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2025, mori vendim të shpall:

K O N K U R S

Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2023/24

I. Kushtet e Përgjithshme

1. Përfitues të bursës universitare do të jenë studentët e nivelit bachelor dhe studentët e nivelit master të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, të cilët i plotësojnë kriteret sipas Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare, me 01-494/A, të datës 29.10.2024, si dhe dispozitave të këtij konkursi.
2. Lartësia e bursës do të caktohet me një vendim të veçantë nga Këshilli Drejtues i Universiteti, si parashihet në nenin 3 të Rregullores, me 01-494/A, të datës 29.10.2024, mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
3. Kriteret për përfitim të bursës studentore janë:
 - 3.1. Të jetë student i rregullt i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren;
 - 3.2. Të jetë student i vitit të dytë e më lartë;
 - 3.3. Të mos ketë vit të përsëritur të studimeve;
 - 3.4. Të ketë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve deri në afatin e shtatorit;
 - 3.5. Të ketë notën mesatare së paku:
 - 3.5.1. Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët e nivelit të studimeve Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetin e Shkencave Kompjuterike;
 - 3.5.2. Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët nivelit të studimeve Bachelor të Fakultetit Juridik, Ekonomik, Filologjik dhe të Edukimit;
 - 3.5.3. Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët e nivelit të studimeve Master të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike;

3.5.4. Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët e nivelit të studimeve Master të Fakultetit Juridik, Ekonomik, Filologjik dhe të Edukimit.

II. Dokumentacioni për aplikim

1. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- 1.1. Formulari i aplikimit;
- 1.2. Formulari i deklaratës nën betim;
- 1.3. Pasqyra e notave;
- 1.4. Kopja e letërnjoftimit e Republikës së Kosovës;
- 1.5. Numri i llogarisë bankare (personale).

2. Formulari për aplikim dhe deklarata nën betim gjenden në faqen zyrtare të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren: <https://www.uni-prizren.com>

III. Afati i aplikimit

1. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet pranë Qendrës për Karrierë dhe Alumni (nr.111), në ndërtesën e Fakultetit të Filologjisë (kati I). Afati për aplikim është prej datës 20.02.2025 deri më 06.03.2025.

IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej 5 ditë pune, pas shpalljes së rezultateve.
2. Ankesat dorëzohen në zyrën e arkivit (nr. 308), në ndërtesën e Rektoratit.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

V. Publikimi

Vendimi dhe lista me përfituesit e bursës do të publikohet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve dhe në ueb faqen e Universitetit: <https://www.uni-prizren.com>